

STATUTI I SHOQERISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“EKMEN CONSTRUCTION” sh.p.k

Themeluesit e shoqërisë:

- 1- Meryem Ekmen, atesia Mehmet Emin, amesia Vesile, shtetase Turke, lindur ne Gercüs dhe banuese ne “Pelitkoy Ugurmumcu sok, 1.cadde 1/A Burhaniye, Balikesir, Turqi, lindur me 09.02.1977, me zotesi te plate juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes se Republikes se Turqise me nr. U25992528 dhe me Nr. personal 55618636516; Perfaqesuar me prokure te pergjithshme me nr. 1250 Repertori, Nr.583 Koleksioni, date 23.05.2023 nga Av. Kujtim Qershori, me Nr. Liçence 2874, Nr. Nipti L11507028E.
- 2- Hüseyin Ekmen, atesia Mehmet Resit, amesia Hore, shtetas Turk, lindur ne Gercüs dhe banues ne ne “Pelitkoy Ugurmumcu sok, 1.cadde 1/A Burhaniye, Balikesir, Turqi, lindur me 01.01.1965, me zotesi te plate juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet Pasaportes se Republikes se Turqise me nr.U26211010 dhe me Nr. personal 55654635368, Perfaqesuar me prokure te pergjithshme me nr. 1250 Repertori, Nr.583 Koleksioni, date 23.05.2023 nga Av. Kujtim Qershori, me Nr. Liçence 2874, Nr. Nipti L11507028E.

Sot më datë 1.06.2023, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar miratojnë statutin e shoqërisë tregtare **“EKMEN CONSTRUCTION” sh.p.k**, si më poshtë vijon:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1
Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

Investime ne fushen e ndertimit, ne pasuri te paluajjtshme, :Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: Ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime, germimedhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, veshje fasadash, ndertime rruges, asfaltime, etj. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te materialeve inerte si beton, asfaltobeton etj. Investimi ne fushen e pronave te paluajjtshme (toke, are, pasuri te luajjtshme dhe te paluajjtshme), duke ofruar trajnime dhe konsulence ne kete fushe. Shoqeria mund te bleje te gjitha llojet e pasurive te luajjtshme dhe te paluajjtshme (toke, ara, ndertesa) per te kryer fushen e veprimtarise se saj. Zhvillimi dhe ndermjetesimi i projekteve per rikonstruksionin e ndermarrjeve industriale, sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata per levrim dhe mbi bazen e ketij rifinancimi dhe kreditimi. Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, import eksport i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te shoqerise si dhe te te treteve. Import-eksport, tregtimin e artkikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice e pakice si konfeksione , metrazhe, tekstile, tekstile te perdorura, artikuj te ndryshem industrial si elektronike, kozmetike, bizhuteri. Hapje marketi per tregtim mallrash sipas objektit te shoqerise. Tregtim me shumice dhe pakice mobiliesh te ndryshme, te reja dhe te perdorura. Shoqeria do te kryeje pa kufizim çdo aktivitet tjeter te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt. Edhe pse kompania është e themeluar ne Tirane/Shqiperi, fusha e veprimtarise tregtare nuk është e kufizuar ne kufijte shqiptare. Ajo gjithashtu mund te ushtroje veprimtarine e saj



tregtare edhe ne vende te tjera.

Neni 2

Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaket e shoqerise vendosin qe shoqerine ta emertojne **"EKMEN CONSTRUCTION" sh.p.k.**

2.2. Selia kryesore juridike e Shoqerise ndodhet ne: Rruga Kongresi Permetit, pallati 85, shkalla 4, kati 1, Tirane.

2.3. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3

Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve dhe as keta te fundit nuk mbajne pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

4.5. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

4.6. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte 2,200,000 leke (dy milion e dyqind mije) leke.

Pjesmarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin

e tyre si me poshte:

- Meryem Ekmen lloji i kontributit Leke dhe vlera e kontributit 1.100.000 (nje million e njeqind mije) Leke. Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.100.000 (nje million e njeqind mije) Leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Hüseyin Ekmen lloji i kontributit Leke dhe vlera e kontributit 1.100.000 (nje million e njeqind mije) Leke. Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.100.000 (nje million e njeqind mije) Leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.2. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket e shoqerise.

6.3. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

Neni 7

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise apo edhe kundrejt te treteve, por ortaket kane te drejten e parablerjes.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakeve te shoqerise.

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe Administratori/Administratoret.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Asambleja e shoqerise mund te mbledhet ne seline e shoqerise apo ne ndonje vend tjeter edhe jashte Republikes se Shqiperise dhe te marre vendime.

Te drejatat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaket. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti kontabel i autorizuar ose ortaket e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas procedures te percaktuar me larte, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime.

Ortaket mund te perfaqesohet ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast, ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaket e shoqerise apo nga te perfaqesuarit e tyre.

Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve,

te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket e shoqerise kane te drejte te marre vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbiqyryrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqeria do te administrohet nga një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administratori administron shoqerine duke e perfaqesuar ate kundrejt te treteve.

10.2. Administratori emerohet dhe mund te shkarkohet ne çdo kohe nga Ortaket e shoqerise.


10.3. Administrimi i shoqerise do behet nga Administratori :

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Hasan Fatih Sürücü, shtetas Shqiptar, lindur me 05.05.1975, identifikuar me ID me nr. personal H50505293N madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

Afati i emërimit, është 5 vjet.


Nenshkrimi :



Meryem Ekmen, shtetase Turke, lindur me 09.02.1977, mbajtese e Pasaportes se Republikes se Turqise me nr. U25992528 dhe me Nr. personal 55618636516.

Afati i emërimit, është 5 vjet.

Nenshkrimi: Perfaqesuar me prokure te pergjithshme me nr. 1250 Repertori, Nr.583 Koleksioni, date 23.05.2023 nga Av. Kujtim Qershori,



Administratoret i ushtrojne kompetencat pa kufizim te dy se bashku ose veç e veç.



10.4.Kohezzgatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.

10.5.Administratori ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

10.6.Administratorit i takon firma/nenshkrimi i lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

10.7.Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

10.8.Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane :

- Te hape llogari bankare ne emer te shoqerise ne te gjitha bankat qe gjykon ai.
 - kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaket :
 - perfaqesojne shoqerine tregtare.
 - kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
 - pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakeve per miratim.
 - krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
 - kryejne regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.
 - raportojne perpara ortakeve te shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
 - kryejne detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
 - administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaket e shoqerise.
 - Kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise sipas kufizimeve te percaktuara ne statut.
 - te perfaqesojne Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, sipas kufizimeve te percaktuara ne statut te nenshkruaj kontrata ne emer te shoqerise dhe te ndjeke zbatimin e tyre.
 - ti propozojne ortakeve per miratim strukturen e organizmes se Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
 - ti propozojne ortakeve per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.
- 10.9 Kufizimet ne llogarite bankare dhe angazhimit te shoqerise me detyrime:
- Mund te kryej pa asnje kufizim: pagesat e pagave, taksave, taksat vendore, kontributet sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, pagesat doganore tarifa te tjera shteterore;
 - Mund te kryej pagesat e kontratave te qirave mujore sipas vleres se tyre, pagesat mujore te sherbimeve te kontabilitetit, juridike sipas vleres se kontratave te tyre.

Kreu VI VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 11

11.1.Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

11.2.Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen



nga Ortaket.

11.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 12

Kontrolli i Shoqerise

12.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga Ortaket.

12.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise, kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepunatore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e Ortakeve.

12.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e Ortakeve.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 13

13.1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

13.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaket emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

13.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaket vendosin mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

13.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per Ortaket e shoqerise.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

14.1. Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 15


15.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit koherent.

15.2. Ky statut hartohet ne 3 (tre) kopje, ne gjuhen turke dhe shqipe, secila me te njejten vlere ligjore, ne rast kundershtrie versioni ne gjuhen shqipe do te mbizoteroje. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

- 1- Meryem Ekmen, atesia Mehmet Emin, amesia Vesile, shtetase Turke, lindur ne Gercüs dhe banuese ne "Pelitkoy Ugurmumcu sok, 1.cadde 1/A Burhaniye, Balikesir, Turqi, lindur me 09.02.1977, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes se Republikes se Turqise me nr. U25992528 dhe me Nr. personal 55618636516; Perfaqesuar me prokure te pergjithshme me nr. 1250 Repertori, Nr.583 Koleksioni, date 23.05.2023 nga Av. Kujtim Qershori, me Nr. Liçence 2874, Nr. Nipti L11507028E.

Kujtim Qershori



- 2- Hüseyin Ekmen, atesia Mehmet Resit, amesia Hore, shtetas Turk, lindur ne Gercüs dhe banues ne ne "Pelitkoy Ugurmumcu sok, 1.cadde 1/A Burhaniye, Balikesir, Turqi, lindur me 01.01.1965, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nepermjet Pasaportes se Republikes se Turqise me nr.U26211010 dhe me Nr. personal 55654635368, Perfaqesuar me prokure te pergjithshme me nr. 1250 Repertori, Nr.583 Koleksioni, date 23.05.2023 nga Av. Kujtim Qershori, me Nr. Liçence 2874, Nr. Nipti L11507028E.

Kujtim Qershori

